



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCË SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TIRANË, MË 4 DHJETOR 2025

MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA NË ARSIMIN FILLOR - SFIDA DHE PERSPEKTIVA NË EPOKËN DIGJITALE DHE TË INTELIGJENCËS ARTIFICIALE

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i Universitetit të Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Universitetin e Poitiers, Universitetin e Varshavës, British Council Albania, Aleancën Franceze të Tiranës, Goethe-Zentrum Tirana, Institutin Italian të Kulturës në Tiranë, Shoqatën e Mësuesve të Gjuhës Franceze (APFA Albanie), Shoqatën e Mësuesve të Gjuhës Gjermane (ADV), Shoqatën e Mësuesve të Gjuhës Angleze (Elta Albania), Shoqatën e Mësuesve të Gjuhës Italiane (APAD), fton studiuesit shkencorë brenda dhe jashtë vendit të marrin pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare “*Mësimi i gjuhëve të huaja në arsimin fillor - Sfida dhe perspektiva në epokën digjitale dhe inteligjencës artificiale*” më 4 dhjetor 2025 në Tiranë, Shqipëri.

Komisioni Evropian, në planin e veprimit 2004-2006 “Promovimi i mësimit të gjuhëve dhe diversitetit gjuhësor”, shprehu qëllimin e tij për të forcuar dhe zgjeruar mësimdhënien e hershme të një ose më shumë gjuhëve moderne ose gjuhëve të tjera në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Duke prezantuar raportin e ri “Eurydice” mbi mësimdhënien moderne të gjuhëve (2005), Ján Figel’ deklaroi: “Në një Evropë shumëgjuhëshe dhe të zgjeruar, mësimi i gjuhëve të huaja që në moshë të re është thelbësor për zbulimin e kulturave të tjera dhe përgatitjen për lëvizshmëri profesionale.” Më 22 nëntor 2005, Komisioni Evropian paraqiti një raport (Nr. 596) mbi shumëgjuhësinë në Këshillin Evropian, Parlamentin Evropian, Komitetin Evropian për Çështje Ekonomike dhe Sociale dhe Komitetin e Rajoneve. Ky dokument zyrtar thekson rëndësinë e mësimdhënies së hershme të gjuhëve të huaja. Gjithashtu, ai tërheq vëmendjen te Plani i Veprimit 2004-2006 (Komunikimi 449 i vitit 2003 II.1.3), i cili thotë se: “... mësimdhënia e hershme e gjuhëve ofron përfitime të konsiderueshme vetëm nëse mësuesit janë trajnuar posaçërisht për t’u mësuar gjuhë fëmijëve shumë të vegjël, nëse madhësia e klasave është mjaftueshëm e vogël për të lejuar të nxëniet efektiv, nëse janë në dispozicion materiale të përshtatshme mësimore dhe nëse një pjesë e mjaftueshme e kurrikulës i kushtohet gjuhëve.”

Entuziazmi i fëmijëve për gjuhë dhe kultura të tjera duhet të nxitet në mënyrë aktive dhe nuk mund të lihet në dorë të fatit. Kjo perspektivë konfirmohet nga disa studime (Blondin, et al. 1998; Edelenbos & de Jong, 2004), të cilat theksojnë se mbetet shumë për t’u bërë dhe se

avantazhet e mundshme të të nxënit të hershëm të gjuhëve të huaja në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian të mund të shndërrohen në përfitime reale. Dokumenti i punës i Komisionit mbi “Progresin drejt objektivave të Lisbonës në arsim dhe formim” (mars 2005) ofron një pasqyrë të strategjive dhe hapave që duhen ndërmarrë deri në vitin 2010, në mënyrë që sistemi evropian i arsimit dhe formimit të bëhet më i miri në botë. Ai gjithashtu përmban një kapitull që merret me mësimdhënien e gjuhëve të huaja: “Parimet kryesore pedagogjike në mësimdhënien e gjuhëve për fëmijët shumë të vegjël”. Qëllimi është të mos nënvlerësohet shumëllojshmëria e metodave të hershme të mësimdhënies së gjuhëve të huaja në Evropë dhe as ndryshimet konceptuale, të cilat kërkonin një përshkrim të praktikave të mira dhe një pasqyrë të hulumtimit në fushën e të nxënit të hershëm. Këto dy qasje plotësuese synojnë të hulumtojnë, shpjegojnë, krahasojnë dhe përshkruajnë më mirë parimet pedagogjike në kontekstin e tyre sociokulturor.

Në këtë drejtim, edhe në Shqipëri janë ndërmarrë reforma të rëndësishme në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja, ku strategjia e zhvillimit të arsimit vendos në qendër përmirësimin e cilësisë, në përputhje me standardet europiane, si dhe zhvillimin profesional të mësuesve. Vizioni i sistemit arsimor synon ndërtimin e një sistemi që bazohet në interesat e nxënësve, promovon përdorimin e njohurive dhe kompetencave për zgjidhjen e problemeve, vlerëson dhe përfshin diversitetin kulturor dhe gjuhësor, si edhe integron teknologjitë moderne për të nxitur të nxënit gjatë gjithë jetës.

Akset kryesore të konferencës

- Përparësitë e mësimi shumëgjuhësor në shkollën fillore, konteksti dhe përvoja shqiptare;
- Problemet dhe sfidat në përvetësimin e kompetencës shumëgjuhësore nga fëmijët;
- Formimi i mësuesve dhe roli i tyre në zhvillimin e kompetencave gjuhësore të fëmijëve;
- Përmbajtja e kurrikulave dhe librave shkollorë të gjuhëve të huaja për fëmijët;
- Ndikimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në mësimin e gjuhëve në moshë të hershme;
- Faktorët psikologjikë dhe ndikimi i tyre në procesin e të nxënit të gjuhëve të huaja nga fëmijët.

Burime dhe referenca

Këto burime mund të jenë të dobishme për të kuptuar më mirë ndikimin e mësimi të gjuhëve të huaja në zhvillimin psikologjik dhe konjitiv të fëmijëve.

- Këshilli i Europës ka zhvilluar projekte mbi gjuhët e shkollimit dhe kompetencën shumëgjuhësore. Mund të konsultoni [Platformën e burimeve për arsimin shumëgjuhësor dhe ndërkulturor](#).
- Komisioni Evropian ka publikuar një dokument mbi qasjen gjithëpërfshirëse në mësimin e gjuhëve, të cilin mund ta gjeni [këtu](#).
- Strategjia e BE-së për mësimin e gjuhëve në arsimin parashkollor është e përfshirë në një raport të detajuar mbi politikat e hershme të gjuhës, të cilën mund ta gjeni [këtu](#).

- Karakteristikat e fëmijëve si nxënës të gjuhëve: ky studim nga Cambridge University Press analizon se si fëmijët e kësaj moshe mësojnë gjuhë dhe cilat janë përfitimet e hershme të ekspozimit ndaj gjuhëve të huaja, të cilin mund ta gjeni [këtu](#).
- Artikulli “Përfitimet konjitive, akademike dhe sociale të mësimi të gjuhëve të huaja” diskuton se si mësimi i gjuhëve ndikon në zhvillimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve, kujtesës, fleksibilitetit konjitiv dhe ndërveprimit social te fëmijët. Mund ta lexoni [këtu](#).
- A ka përparësi konjitive dygjuhësia te fëmijët? Një meta-analizë e studimeve mbi efektet e dygjuhësisë në funksionet ekzekutive të fëmijëve, duke përfshirë vëmendjen, kujtesën dhe aftësinë për të kaluar mes detyrave, të cilën mund ta gjeni [këtu](#).

SEANCA PLENARE

RËNDËSIA E MËSIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA NË SHKOLLAT FILLORE DHE ORIENTIMET E KËSHILLIT TË EVROPËS

- Prezantimi i orientimeve të Këshillit të Evropës mbi arsimin shumëgjuhësor dhe shumëkulturore
- Diskutimi i Rekomandimit CM/Rec(2022) mbi rëndësinë e arsimit shumëgjuhësor dhe shumëkulturore për kulturën demokratike (book.coe.int)
- Analiza e përfitimeve konjitive, gjuhësore dhe sociale të mësimi të disa gjuhëve
- Rëndësia e zhvillimit të kompetencave shumëgjuhësore dhe shumëkulturore që në moshë të hershme shkollore

SESIONE PARALELE

1. Aspektet neuropsikologjike të mësimi të gjuhëve të huaja në moshë të hershme

- Studime mbi zhvillimin e trurit dhe ndikimi i mësimi të disa gjuhëve
- Strategji për mbështetje të zhvillimit konjitiv përmes mësimi të gjuhëve
- Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në mësimin e gjuhëve

2. Qasjet pedagogjike dhe metodologjike në mësimin e gjuhëve të huaja në shkollat fillore

- Metoda të ndryshme të mësimi të gjuhëve të huaja në këtë grupmoshë
- Përgatitja e mësuesve për mësimin e gjuhëve të huaja në shkollën fillore
- Përdorimi i materialeve mësimore dhe teknologjisë në mësimin e gjuhëve në përshtatje me këtë grupmoshë

3. Përdorimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në mësimin e gjuhëve të huaja nga fëmijët

- Aplikacione dhe mjete digjitale për mësimin e gjuhëve
- Përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjisë në mësim
- Roli i inteligjencës artificiale në personalizimin e mësimi

4. Zhvillimi i kompetencave shumëgjuhësore dhe shumëkulturore që në moshë të hershme

- Strategji për integrimin e diversitetit gjuhësor dhe kulturor në mësim
- Aktivitete për zhvillimin e ndërgjegjësimit kulturor dhe gjuhësor
- Rëndësia e bashkëpunimit me familjet dhe komunitetin në procesin e mësimin

Data të rëndësishme:

Afati i fundit për dorëzimin e abstraktit: **31 tetor 2025**

Njoftimi i pranimit të punimeve: **10 nëntor 2025**

Dorëzimi i artikujve të plotë: **23 janar 2026**

Njohja me programin përfundimtar: **25 nëntor 2025**

Tarifa e pjesëmarrjes: **3 mijë lekë ose 30 euro**

Abstraktet për pjesëmarrje dorëzohen përmes plotësimit të formularit:

<https://forms.office.com/e/vPy4kJM7G5>

Udhëzime të përgjithshme mbi referimet: referimet në konferencë do të jenë vetëm në gjuhë të huaj. Në rastet e prezantimeve në gjuhë të ndryshme nga ajo angleze, dokumenti i prezantimit (Power Point, Prezti etj) duhet të jetë në gjuhën angleze.

Udhëzime të përgjithshme për dorëzimin e abstraktit: abstrakti duhet të jetë në gjuhën angleze, jo më shumë se 250 fjalë së bashku me fjalët kyç. Aplikimi duhet të përmbajë titullin, emrat e autorëve, institucionin përkatës, aksin kërkimor të referimit dhe adresën e-mail të autorit të parë. Për më shumë kliko [Udhëzime](#)

Çdo pjesëmarrës mund të aplikojë vetëm me një abstrakt kërkimor për vlerësim.

Nuk lejohet të aplikohet disa herë me të njëjtin abstrakt nga emra të ndryshëm.

Gabime drejtshkrimore: është përgjegjësi e pjesëmarrësit të sigurohet që të dhënat dhe teksti të mos përmbajnë gabime drejtshkrimore si dhe të jetë në formatin Word (docx apo .doc)

Komiteti organizues

Esmeralda Kromidha - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Anida Kisi - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Andromaqi Haloçi - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Leonora Xhori - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

Rudina Koromani - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Staf administrativ

Ardita Poda - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Staf administrativ